

MOTIVIMI I PËRDORIMIT TË SIMBOLEVE MITOLOGJIKE

Epokat, drejtimet dhe rrymat letrare kanë përdorur simbolika me mite dhe qëndrime mitizuese në mënyra të ndryshme, deri në skaje krejt të kundërta. Ekzistojnë dy botëkuptime kryesore për klasifikimin e mitit: i pari, është miti prehistorik, që përfshin mitet e krijuara në periudhën para erës sonë. Ndërsa i dyti, është miti i krijuar në monoteizëm, i cili ka një shtrirje të gjerë në të gjitha veprimtaritë njerëzore.

Në poezinë moderne gjithnjë e më shumë vihet re prirja për të risemantizuar elementet mitike dhe sidomos mitet prehistorike. Kjo prirje është shtrirë edhe në poezinë shqipe bashkëkohore, e cila, ndryshe nga poezia klasike, tregon një interesim shumë të madh për lëndën mitologjike. "Kjo ka ardhur si rezultat i shmangies nga realiteti bashkëkohor, në kërkim të disa fillesave të përjetshme e të pandryshueshme, që vënë në lëvizje në një mënyrë misterioze, si jetën e rëndomtë të njerëzve, ashtu dhe ngjarjet historike."¹

Mënyrat e lidhjes së poezisë shqipe me mitologjinë, ndryshojnë nga poezia moderne evropianoperëndimore, sepse bëhen në përshtatje me një përvojë tjetër historike dhe kulturore. Një formë të kësaj lidhjeje e gjejmë tek poezia e Ali Podrimjes, ku ringjallet miti në strukturën poetike, duke qenë se mitet kanë funksione të caktuara në përshtatshmëri me simbolikën e së sotmes.

Në një sërë poezish shfaqen figura, reminishenca, motive e personazhe të mitologjisë. Ky ndikim është përgjithësisht i rifunksionalizuar, sepse mitet nuk janë dukuri të fotografuara, që kanalizohen vetëm në një përmasë kuptimore, por karakterizohen nga dykuptimësia.

Koha e formimit të simboleve mitologjike është e ndryshme dhe si pasojë ekzistojnë edhe ndryshime midis tyre, por për të shpjeguar funksionin që kanë në poezinë moderne do t'i shikojmë si tërësi. Prandaj përdorimi i simboleve mitologjike përliqjet nga disa përbërës dhe funksione të tyre, të cilat radhiten si më poshtë:

I. Gjuha e simboleve

Miti është i pranueshëm në kodin e sjelljes sociale dhe ka si tipar themelor oralitetin. Ky tipar është pika tangjente që lidh mitin me kujtesën, që e parë nga pikëpamja gjuhësore, kujtesa orale është më e rëndësishme se ajo e shkruar. Oraliteti ka karakter të pashpërthyer, atomizues ose potencial, i cili ruan vetëm thelbin ose kuptimet më të qenësishme dhe pranon ndryshimet. Ndërsa gjuha e shkruar është e kristalizuar dhe nuk pranon ndryshime. Kështu, "domethënia e simbolit mitologjik nuk është e ngurtësuar njëherë e përgjithmonë, por gjenerohet varësisht nga konteksti".² Ky gjenerim është i pashtershëm sepse mundësohet nga gjuha simbolike e mitit, ndryshe nga shenja që është e shtershme.

Për gjuhën simbolike, Erich Fromm shkruan se "është e vetmja gjuhë universale e krijuar prej njeriut, që ka mbetur e njëjtë për çdo qytetërim dhe gjatë gjithë historisë."³

Podrimja gjeneron mitet e antikitetit në një tjetër optikë, pikërisht në optikën e bashkëkohësisë, shpesh "duke krijuar realitetin mbi një shtrat mitik"⁴. Kjo optikë realizohet me anë të individualizimit të elementit mitik, duke ruajtur prej tij vetëm simbolikën thelbësore.

"Zhvendosja e mitit nga një vend në një vend tjetër dhe nga një kohë në një kohë tjetër, përbën dukurinë e ndryshimit tematik të tij."⁵ Kjo vjen nëpërmjet intertekstit, ku ka kondensim semantik me një synim të caktuar.

"Gjuha e simboleve mitologjike përmbys logjikën e gjërave që ne njohim në jetën e përditshme, shkel kategorinë e kohës dhe të hapësirës dhe ka një sintaksë të vetme që dallon nga gjuha e përditshme."⁶

II. Funkzioni socio-kulturor

Miti rimerret në momentet e krizës ekzistenciale të së tashmes. Kriza mund të jetë e identitetit vetjak ose e identitetit kombëtar. Në poezitë e Podrimjes, kriza e identitetit vetjak të bashkëkohësit, shpërhapet me anë të gjuhës simbolike, si një progresion në rritje për mbarë identitetin kombëtar. Situata pa rrugëdalje e së tashmes kërkon kthimin tek tradita. Rimarrja e traditës është siguri, mbrojtje dhe e bën më të besueshëm mesazhin poetik. Çdo mit, çdo traditë krijon identitetin dhe shpreh siguri për çastin. Nevoja për rimarrjen e simboleve mitologjike lind nga kërkesa e njeriut për të kërkuar rrënjët e vetvetes, për t'u mbrojtur, për një mbështetje, për të krijuar arketipin social a individual dhe për të siguruar fillin gjenetik të prejardhjes. Shpesh tradita evokohet për të paraqitur kontrastet.

Poezitë e Podrimjes përmbajnë një sërë simbolesh që krijojnë sfondin e sigurisë. Të tilla janë *Anteu*, *Prometeu*, *Itaka*, *Olimpi* dhe *Sfinksi*.

“Poeti merr kryesisht simbole të antikitetit grek për të markuar rrënjët e hapësirës etnike shqiptare”,⁷ pra shfrytëzon mite të një tradite të konsoliduar për t'i përshtatur në kronotoposin^{*8} e bashkëkohësisë.

III. Përshtatja me kontekstin historik

Risemantizimi i simboleve mitologjike bëhet në përshtatje me kushtet historike në të cilat ndodh ky proces, prandaj këto simbole do të kuptohen në ndërlidhje me vet kontekstin shoqëror. Sinkretizmi i simboleve mitologjike me ato historike, hedh dritë mbi mjegullën semantike.

“Miti ka funksion në zbërthimin e jetës së njeriut, ai del njëkohësisht diakronik dhe sinkronik, domethënë:

Si një rrëfim (narracion) apo histori mbi të shkuarën.

- Si një farë mjeti që do ta shpjegonte të tashmen, madje edhe të ardhmen e njerëzimit.”⁹

Konceptimi i Podrimjes për mitin është tërësisht “euhemerist, domethënë mbështet lidhjen e pakundërshtueshme midis mitit dhe historisë.

E theksojmë këtë qëndrim pasi në letërsinë neomitike, ekzistojnë edhe konceptime antagoniste midis mitit dhe historisë.”¹⁰

Ringjallja dhe rihyrja e mitit në segmente të ndryshme të historisë, përbën karakterin universal të mitit.

IV. Arketipi

Simbolet mitologjike kanë karakter universalizues, i cili realizohet nëpërmjet dy përbërësve kryesorë:

1- Arketipi

2- Koha ciklike

Të dy këta përbërës plotësojnë njëri-tjetrin, sepse kanë të njëjtën veti, pikërisht, atë të përsëritjes.

Northrop Frye e vështron poezinë “si një prej metodave të civilizimit, ajo merret me aspektin shoqëror të poezisë, me poezinë si qendër e një bashkësie. Simboli në këtë metodë njihet me emrin kryetip ose arketip: do të thotë imazh tipik ose përsëritës.”¹¹ Pra, “arketipi është shëmbëllturyrë tipike dhe përsëritëse si simbol që njëson veprat dhe ndërlidh letërsinë.”¹²

Në këto poezi arketipet shenjohen plotësisht, sepse emrat e tyre nuk transformohen, por mbarten me simbolin përkatës ashtu si në trajtën fillestare. Kjo vjen për shkak të natyrës së brendshme të arketipit, i cili nuk është polisemik, por polikontekstual, i zëvendësueshëm në çdo çast me llojin e tij.

Disa nga arketipet kryesore që janë risemantizuar në poezinë e Ali Podrimjes janë: *Kali i Trojës*, *Torzo*, *Sizifi*, *Itaka* dhe *Prometeu*. Këto arketipe shënojnë tipa njerëzorë dhe dukuri shoqërore të realitetit bashkëkohor.

“Arketipet paraqiten si grumbuj asociativë, që ndryshojnë nga shenjat ngaqë janë variable komplekse. Brenda këtij kompleksi gjenden shpesh një numër i madh i asosacioneve specifike të mësuara, që janë të komunikueshme, ngaqë një numër i madh i njerëzve në një kulturë të caktuar janë të njohur me to.”¹³ P. sh. Arketipi i Kalit të Trojës, që përdoret në kontekstin e kulturës shqiptare, është përgjithësisht i komunikueshëm dhe për rrjedhojë domethënia e tij e shmang mjegullën semantike. Kali i Trojës simbolizon dredhinë dhe tradhtinë, një simbolikë e tillë universalizohet dhe kthehet në arketip të tradhtisë në gjithë

historinë e njerëzimit.

“Funksioni i arketipit si simbol lidhet me artikulin e të vërtetave të përjetshme, që garantojnë përhershmërinë e ideve, motiveve dhe subjekteve. Nga epoka në epokë ato rimerren, transformohen dhe përjetësohen.”¹⁴

Për nga prejardhja, Jungu dallon dy tipe simbolesh arketipe: natyrale dhe kulturore. “Simbolet natyrale rrjedhin nga përmbajtje të pavetëdijshme të psikës së njeriut, simbolet kulturore janë ato që shfrytëzohen për artikulin e të vërtetave të përjetshme dhe të cilat gjithnjë shfrytëzohen në shumë religjione.”¹⁵ Në poezitë e Ali Podrimjes ka simbole alegorike që kthehen në simbole arketipe. Të tillë janë simbolet historike *Arbëria, Shkodra, Janina, Rozafa, Kruja, Art, Preveza* etj.

Në arketipe kulturore kthehen edhe simbolet stenotermë si: *Gjuha, dheu, fyelli, kulla, guri* etj. Këto simbole janë kulturore dhe arketipe kontekstuale. Ndërfutja në sistemin e shenjave e simboleve arketipore, bën që me *Arbërinë* të mos kuptohet vetëm Shqipëria; *Drini* nuk është thjesht hidronim gjeografik; *dheu* nuk është vetëm tokë. “Simboli alegorik ia lë vendin artikulimit përmbysës, antialegorik e paradoksal.”¹⁶

Gjuha është një simbol kulturor që i kalon caqet e konceptit gjuhë që kishin rilindasit, si gjuhë amtare që duhet ruajtur nga asimilimi. Gjuha këtu është identitet, kujtesë, kulturë, trashëgimi dhe shenjë e parë njohjeje.

Ndërsa *Shkodra* tek poezia “A do ta shoh Shkodrën”, të çon në topose antike si kult i udhëtimit drejt njohjes së historisë. Në fund, shtrohet pyetja retorike, *A do ta shoh Shkodrën*, sepse *Shkodra* është simbol i qëndresës së etnisë dhe i mitit të flijimit.

“Vlera arketipale e këtyre simboleve është një kthim i përhershëm në pjesën e pavetëdijshme të psikës, si kujtesë kolektive që aktivizon vetëm gjuhën e simboleve me tërë fuqinë që ka marrë fjala në dinamikën e përgjithësisimit artistik.”¹⁷

Si përfundim themi që, “ arketipat janë të përjetshëm dhe të përsëritshëm, janë gjithësorë, mishërues të të gjitha racave, vendeve dhe kohëve.”¹⁸

V. Koha ciklike

“Imitimi i veprimt njerëzor si tërësi dhe jo thjesht si një mimesis praxeos, ose si imitim i një veprimi, krijon ritualin që përbën kohën ciklike.”¹⁹

Koha ciklike ose apokaliptike i motivon simbolet mitologjike që të risemantizohen në shumëkohësi. Kjo kohë lidhet me rendin e përmbysur të dukurive, veprimeve dhe imazheve, në kuptimin që gjithçka përsëritet. Rifunksionalizimi i simboleve mitologjike dhe historike përfiton idenë e kohës ciklike. Kjo ndodh pasi “miti ka kohë eternale ose të përjetshme, sepse shfaqet në kontekste të ndryshme kohore dhe nuk të lë mundësi ta futësh brenda prangave të kohës dhe hapësirës historike.”²⁰

Le të marrim një shembull të kohës ciklike. Imazhi i luftës që përsëritet, mishërohet nëpërmjet simboleve të ndryshme: *Troja- Dardania- Arbëria- Albania*. Ka një përshkallëzim kohor dhe hapësinor të së njëjtës dukuri, pra luftës nga antikiteti deri në bashkëkohësi. Koha ecën sipas mënyrës lineare, duke iu nënshtruar gjithmonë rendit ciklik. Trajta e kohës ciklike paraqitet jo vetëm nëpërmjet simboleve, por shprehet edhe drejtpërdrejt në vargjet e poezisë “Kur rrjedh”:

*unë kur rrjedh
vetveten vjell
në pafundësi (f.44)*

Në këto vargje fundi kthehet sërish tek fillimi dhe ky është një kthim i përhershëm. Njeriu projekton vetveten nëpërmjet vijimësisë gjenetike.

“Bota apokaliptike është tërësisht e gjallë, i përket pafundësisë së jetës së gjallë dhe jo botës së përtejme a vdekjes”.²¹

Në mënyrë të përmbledhur Agim Vinca shpjegon se “Podrimja shpreh vizionin e tij apokaliptik mbi botën, përmes simboleve të mitologjisë që paraqesin vizionin e qëndresës së popullit nëpër shekuj, përballë sulmeve të armiqve dhe rrebesheve të tjera të kohës”.²²

Ashtu si në kohën ciklike, që fillimi dhe fundi njësohen, edhe “në strukturat mitike, fillimi dhe mbarimi janë pikë e njëjtë. Kjo gjen më tepër mishërim tek eposet klasike, p.sh. tek Odiseja zotëron tema e nostosit, ose e kthimit në shtëpi”.²³ Kjo strukturë poetike

haset edhe në librin me poezi të përzgjedhura “Litari i ankthit”, që fillon dhe mbaron me temën e fatkeqësisë. Në fillim fatkeqësia shenjohe me simbolin “maca e zezë”, ku sipas mendësive popullore është shenjë kasandrike që ndjell të keqen. Në mbyllje fatkeqësia, shfaqet si profeci e realizuar: -*Guaskë pas guaske zbuloja fatkeqësitë e dherave të Arbërisë...* (Guaska). Këtu fatkeqësia nuk është më në trajtën e parashenjës, por është një fatkeqësi konkrete që shfaqet hap pas hapi në dherat e Arbërisë. Fatkeqësia në të vërtetë shpreh humbjen, e cila është pasoja e shkaqeve që fshihet pas simboleve si *Hadi, dinozaurët, kaosi, uji i dekës, bisha, katallanjtë dhe Troja*.

Imazhet dramatike që mbartin shpesh simbolet mitologjike krijojnë asosacione me gjendjen dramatike të etnisë shqiptare. Në qoftë se lënda mitike frymëzohet nga lufta e njeriut me natyrën, simbolet mitologjike të rifunksionalizuara, krijohen nga lufta e njeriut me njeriun. Rimarrja e simboleve mitologjike dhe përfshirja e tyre në strukturat poetike, e bën poezinë e Ali Podrimjes një trajtë “moderne në kuptimin evropianoperëndimor”.²⁴ Konvencionet letrare moderne përdoren për të trajtuar çështjen e etnisë shqiptare. “Për të shenjuar etninë, Podrimja ikën nga domosdoja e relievit nacional dhe shtrihet në pakufi.”²⁵

“Materiali konkret historik, kryqëzohet me përpjekjen për ta përgjithësuar dhe ngritur atë në rangun e një simboli universal.”²⁶ “Frymëzimin Podrimjes nuk ia jep substanca mitologjike, por realiteti historik shqiptar, që ndërfitet në të dhe ua ndryshon simboleve funksionin ideologjik.” Përfitimi i kuptimeve të reja në figurat mitologjike, e bën poezinë e tij origjinale dhe me tipare moderne. Ky rifunksionalizim, është produkt i vetë funksioneve që mbart miti, të cilat po i paraqesim në mënyrë të përmbledhur:

1. Përshtatja me historinë
2. Gjuha simbolike
3. Trajta e kohës ciklike
4. Aspekti socio- kulturor
5. Përbërësi arketipor

Këta përbërës dhe këto funksione mundësojnë risemantizimin e përhershëm të simboleve mitologjike. Simbole të tilla, Podrimja i bën pjesë të poezive të tij dhe në këtë mënyrë realizon universalitetin, por njëkohësisht nëpërmjet semantikës së tyre

arrin "të rikrijojë shëmbëlltyrën poetike të etnisë dhe të kombit shqiptar, kur ato ishin të copëtuara politikisht dhe mjaft të mjegulluara ideologjikisht."²⁷

Bibliografia:

1. Barthes, Roland. *Mythes*. Në: *Mitologies*, Fayard, Paris, 1957, f. 87- 113.
2. Brooks, David. *Modernism*, Macmillan Publishing Company, 1987.
3. Çapriqi, Basri. *Simboli dhe rivalët e tij*, Kosova Pen Center, Prishtinë, 2005.
4. Elsie, Robert *Dictionary of albanian religion, mythology and folk culture*, The Harvill Press, London, 2000.
5. Fromm, Erich. *Gjuha e harruar*, Dituria, Tiranë, 1998.
6. Frye, Northrop. *Anatomia e kritikës*, Rilindja, Prishtinë, 1990.
7. Holman, Hugh & Harmon, William. *A handbook literature*, Macmillan Publishing Company, 1986.
8. Smith, Ll. *Dictionary of classical mythology*, Kausas, 1924.
9. Todorov, Tzvetan. *Theories of the Symbol*, Cornell University Press, Ithaca, New York, 1995.
10. Vinca, Agim. "Manifesti i simbolizmit dhe tipologjia e simboleve." Në: *Kurs i teorive letrare*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2002.
11. Kuçuku, Bashkim. "Shprehja moderne e etnisë shqiptare". Në: *Litari i ankthit*, Toena, Tiranë, 2002.
12. Rugova, Ibrahim. *Statëgjia e kuptimit*, Rilindja, Prishtinë, 1980.
13. Topçiu, Luan. *Përmasa moderne në letërsinë shqipe*, Flaka, Shkup, 2002.
14. Uçi, Alfred. *Mitologjia, letërsia dhe folklori*, Naim Frashëri, Tiranë, 1982.